

**AYEN ENERGY TRADING sh.a**  
**Raporti i audituesit të pavarur dhe**  
**Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

---

**PËRMBAJTJA:**

	<b>FAQE</b>
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	1
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E PERFORMANCËS	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	5
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	6
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	7 – 21

## RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

**Drejtuar: Menaxhimit dhe aksionerëve të Shoqërisë AYEN ENERGY TRADING sh.a**

### Raport mbi Pasqyrat Financiare

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëngjitur të shoqërisë AYEN ENERGY TRADING sh.a, (më poshtë "Shoqëria") të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar të datës 31 dhjetor 2016, pasqyrën e performancës, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 Dhjetor 2016, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara në Shqipëri.

### Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

### Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuadojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.


### Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrijmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënime shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënime shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.




**Teit Gjini**  
Auditues Ligjor

28 shkurt 2017



Rr. Emin Duraku - Pall. "Binjakët",  
No 5, 1000, Tirana, Albania  
phone: +355 42 27 80 15  
www.mazars.al, info@mazars.al



**AYEN ENERGY TRADING sh.a**
*(Vlerat janë në Lek)*
**Pasqyra e Pozicionit Financiar  
më 31 dhjetor 2016**

	Shënime	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
<b>AKTIVET</b>			
<b>Aktive afatshkurtra</b>			
Mjete monetare	4	60,478,222	69,065,502
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	98,330,475	90,593,493
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	22	120,285,847	16,436,627
Të tjera llogari të arkëtueshme	6	44,654,923	24,269,807
Shpenzime të shtyra	7	3,864,827	3,724,222
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>327,614,294</b>	<b>204,089,651</b>
<b>Aktivitet afatgjata</b>			
Aktive afatgjata material	8	5,056,262	6,045,818
<b>Totali i aktiveve afatgjata</b>		<b>5,056,262</b>	<b>6,045,818</b>
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>332,670,556</b>	<b>210,135,469</b>
<b>DETYRIMET</b>			
<b>Detyrime afatshkurtra</b>			
Llogari të pagueshme tregtare	9	68,685,012	4,081,212
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	22	208,962,539	153,432,678
Detyrime tatimore	10	762,371	690,144
Detyrime të tjera ndaj paleve të lidhura	11,22	88,397,775	88,866,459
Të tjera detyrime	12	3,344,894	2,304,485
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>		<b>370,152,591</b>	<b>249,374,978</b>
<b>Detyrime afatgjata</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>370,152,591</b>	<b>249,374,978</b>
<b>Kapitali</b>			
Kapitali i nënshkruar		3,500,000	3,500,000
Fitime/(humbje) të mbartura		(42,739,509)	(18,134,531)
Fitimi i ushtrimit		1,757,474	(24,604,978)
<b>Totali i kapitalit</b>	13	<b>(37,482,035)</b>	<b>(39,239,509)</b>
<b>Totali i kapitalit dhe detyrimeve</b>		<b>332,670,556</b>	<b>210,135,469</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



Pasqyra e Performancës  
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	14	1,049,738,741	444,149,477
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	15	(127,863)	(658,790)
<b>Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe të tjera shpenzime</b>		<b>(1,016,986,811)</b>	<b>(436,989,587)</b>
Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe shpenzime të tjera	16	(998,284,179)	(425,736,422)
Të tjera shpenzime	17	(15,728,730)	(11,253,165)
<b>Shpenzime të personelit</b>	<b>18</b>	<b>(29,858,290)</b>	<b>(30,027,673)</b>
<i>Paga dhe shpërblime</i>		<i>(28,045,838)</i>	<i>(28,394,348)</i>
<i>Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore</i>		<i>(1,812,452)</i>	<i>(1,633,325)</i>
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	8	(1,476,859)	(1,809,116)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	19	(128)	(107,190)
<b>Shpenzime financiare</b>	<b>20</b>	<b>2,505,218</b>	<b>837,901</b>
<i>Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme</i>		<i>(865,022)</i>	<i>(1,007,259)</i>
<i>Shpenzime të tjera financiare</i>		<i>(1,640,196)</i>	<i>1,845,160</i>
<b>Fitimi/humbja para tatimit</b>		<b>1,757,474</b>	<b>(24,604,978)</b>
<b>Shpenzimi i tatimit mbi fitimin</b>	<b>21</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		-	-
Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë		-	-
<b>Fitimi/humbja e vitit</b>		<b>1,757,474</b>	<b>(24,604,978)</b>
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
<b>Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin</b>		<b>1,757,474</b>	<b>(24,604,978)</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



**AYEN ENERGY TRADING sh.a***(Vlerat janë në Lek)*

Pasqyra e ndryshimeve në Kapital  
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

	Kapitali aksionar	Fitime/(humbje) te mbartura	Fitimi/(humbja) e ushtrimit	Total
<b>Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2014</b>	<b>3,500,000</b>	<b>(383,136)</b>	<b>(17,751,395)</b>	<b>(14,634,531)</b>
Të ardhura totale gjithëpërfshirë për vitin:			(24,604,978)	(24,604,978)
Transferimi ne rezultatit e mbartur		(17,751,395)	17,751,395	-
Dividendë të paguar				-
<b>Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2015</b>	<b>3,500,000</b>	<b>(18,134,531)</b>	<b>(24,604,978)</b>	<b>(39,239,509)</b>
<b>Totali i të ardhura gjithëpërfshirë për vitin:</b>			<b>1,757,474</b>	<b>1,757,474</b>
Transferimi ne rezultatit e mbartur		(24,604,978)	24,604,978	-
Dividendë të paguar				-
<b>Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2016</b>	<b>3,500,000</b>	<b>(42,739,509)</b>	<b>1,757,474</b>	<b>(37,482,035)</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 janë aprovuar nga administratori i Ayen Energy Trading sh.a më 28 shkurt 2017 dhe janë firmosur si më poshtë.



Fahrettin Amir Arman  
Administrator

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare  
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015
<b>Flukset e parasë nga aktivitetet operative</b>		
Fitim / Humbja e vitit	1,757,474	(24,604,978)
<i>Rregullimet për shpenzimet jomonetare:</i>		
Interes i perlllogaritur	865,022	1,007,259
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	1,476,859	1,809,116
Diferenca kembmi jo nga aktivitetet operative	(138,338)	(1,627,005)
<b>Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:</b>		
Ndryshimet në aktivitet dhe detyrimet e shfrytëzimit:		
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(132,111,923)	(94,858,766)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	120,205,888	157,157,832
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	1,040,409	1,323,587
<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit</b>	<b>(6,904,609)</b>	<b>40,207,045</b>
<b>Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit</b>		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(487,303)	(819,572)
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	-	-
<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit</b>	<b>(487,303)</b>	<b>(819,572)</b>
<b>Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit</b>		
Hua të arkëtuara	-	-
Pagesa e huave	-	7,021,760
<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit</b>	<b>-</b>	<b>7,021,760</b>
<b>Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare</b>	<b>(7,391,912)</b>	<b>46,409,233</b>
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	69,065,502	22,874,424
<i>Efekt i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare</i>	(1,195,368)	(218,155)
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor</b>	<b>60,478,222</b>	<b>69,065,502</b>

4

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



## **1. Informacion i përgjithshëm**

Ayen Energy Trading sh.a, është një shoqëri e regjistruar më 25 shtator 2013 si shoqëri aksionare në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit në përputhje me ligjin 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Shoqëria ka nipt L32130008F. Selia e shoqërisë është Rruga "Papa Gjon Pali i II-të", ABA Business Center, Kati 11, Njësia Bashkiake Nr.2, Tiranë, Shqipëri.

Kapitali i shoqërisë përbëhet nga 35 aksione me vlerë nominale 100,000 LEK për një vlerë totale 3,500,000 LEK. Aksioneri i vetëm i shoqërisë është Ayen Electric Ticaret Anonim Sirketi. Administrator i shoqërisë është Z. Fahrettin Amir Arman.

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është sigurimi, transmetimi, shpërndarja, importimi, eksportimi dhe tregtimi me shumicë ose pakicë brenda dhe jashtë vendit të energjisë elektrike.

Në 31 dhjetor 2016 shoqëria ka 10 punonjës (2015: 10).

## **2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare**

### **2.1. Deklarata e pajtueshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

### **2.2. Bazat e matjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

### **2.3. Biznesi në vijimësi**

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

### **2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes**

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

### **2.5. Vlerësime dhe gjykime**

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:



## 2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

### 2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

### 2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

## 3. Politikat Kontabël


Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

### 3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2016	2015
Euro/LEK	135.23	137.28
USD/ LEK	128.17	125.79
GBP/LEK	157.56	186.59



### 3. Politikat Kontabël (vazhdim)

#### 3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

##### *Mjetet monetare*

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

##### *Llogari të arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

##### *Llogari të pagueshme*

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

##### *Hua të marra dhe të dhëna*

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

##### *Vlera e drejtë*

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

##### *Të tjera*

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.



### 3. Politikat Kontabël (vazhdim)

#### 3.2. Instrumentat financiare

##### *Kapitali aksionar*

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapitale.

##### *Zhvlerësimi i aktiveve financiare*

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitetet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitetet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitetet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

#### 3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

#### 3.4. Aktive afatgjata materiale

##### *i. Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivitetet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.


Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

##### *ii. Kostot e mëpasshme*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.



### 3. Politikat Kontabël (vazhdim)

#### 3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

##### iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2016 dhe 2015 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mobilje për zyren dhe kantierin	Vlera e mbetur	20 %
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25 %

##### iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

#### 3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundur që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

Shoqëria i njeh të ardhurat kur transmeton energjinë.

#### 3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

#### 3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shoqëria ka vetem qira operative.



### 3. Politikat Kontabël (vazhdim)

#### 3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

#### 3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2016 është 15% (2015: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

Shoqëria nuk ka njohur tatim të shtyrë për humbjet e mbartura fiskale.

#### 3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

#### 3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

#### 3.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.



**3. Politikat Kontabël (vazhdim)****3.13. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara**

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

**4. Mjete monetare**

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Mjete monetare në bankë	60,251,351	68,638,985
Mjete monetare në arkë	226,871	426,517
	<u>60,478,222</u>	<u>69,065,502</u>

**5. Llogari të arkëtueshme tregtare**

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Klientë në lekë	98,330,475	90,593,493
	<u>98,330,475</u>	<u>90,593,493</u>

**6. Të tjera llogari të arkëtueshme**

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
TVSH e zbritëshme	43,714,331	23,331,339
Garanci	938,468	938,468
Të tjera të arkëtueshme	2,124	-
	<u>44,654,923</u>	<u>24,269,807</u>

**7. Shpenzime të shtyra**

Shpenzimet e shtyra detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Shpenzime të shtyra	3,864,827	3,724,222
	<u>3,864,827</u>	<u>3,724,222</u>



**AYEN ENERGY TRADING sh.a**  
**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**  
*(Vlerat janë në Lek)*

**8. Aktive Afatgjata Materiale**

	Kompjutera	Pajisje zyre	Totali
<i>Kosto</i>			
Gjendja më 1 janar 2015	5,722,024	1,584,349	7,306,373
Shtesa	-	819,572	819,572
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2015</b>	<b>5,722,024</b>	<b>2,403,921</b>	<b>8,125,945</b>
Shtesa	487,303	-	487,303
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2016</b>	<b>6,209,327</b>	<b>2,403,921</b>	<b>8,613,248</b>
<i>Zhvierësimi i akumuluar</i>			
Gjendja më 1 janar 2015	238,375	32,636	271,011
Amortizimi i vitit	1,602,690	206,426	1,809,116
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2015</b>	<b>1,841,065</b>	<b>239,062</b>	<b>2,080,127</b>
Amortizimi i vitit	1,043,887	432,972	1,476,859
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2016</b>	<b>2,884,952</b>	<b>672,034</b>	<b>3,556,986</b>
<i>Vlera neto kontabël</i>			
Gjendja më 31 dhjetor 2015	3,880,959	2,164,859	6,045,818
Gjendja më 31 dhjetor 2016	3,324,375	1,731,887	5,056,262



**AYEN ENERGY TRADING sh.a**  
**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

*(Vlerat janë në Lek)*

**9. Llogari të pagueshme tregtare**

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Llogari të pagueshme tregtare	68,685,012	4,081,212
	<u>68,685,012</u>	<u>4,081,212</u>

**10. Detyrime tatimore**

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Sigurimet Shoqërore	250,582	264,468
Tatim mbi te ardhurat personale	403,208	425,676
Tatim në burim	108,581	-
	<u>762,371</u>	<u>690,144</u>

**11. Të pagueshme ndaj palëve të lidhura**

Të pagueshmet ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Detyrime të tjera ndaj palëve të lidhura	88,397,775	88,866,459
Llogari të pagueshme tregtare ndaj palëve të lidhura	208,962,539	153,432,678
	<u>297,360,314</u>	<u>242,299,137</u>

**12. Të tjera detyrime**

Detyrimet e tjera paraqesin detyrimet ndaj punonjësve më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Paga të pagueshme	3,344,894	2,304,485
	<u>3,344,894</u>	<u>2,304,485</u>

**13. Kapitali aksionar**

Kapitali aksionar i shoqërise është 3,500,000 LEK i zotëruar 100% nga shoqëria mëmë Ayen Electric Ticaret Anonim Sirketi.

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Numri aksioneve	35	35
Vlera nominale (në LEK)	100,000	100,000
Kapitali aksionar	<u>3,500,000</u>	<u>3,500,000</u>

Shoqëria ka humbje të mbartura më 31 dhjetor 2016 në vlerën 42,739,509 LEK (2015: 18,134,531 LEK).



14. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Shitje energjie	1,015,040,579	440,493,538
Tarifë transmetimi	11,534,733	3,457,965
Shitje energjie për konsum	23,163,429	197,974
	<b>1,049,738,741</b>	<b>444,149,477</b>

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së.

	31 dhjetor 2016
<b>Rakordimi i të ardhurave me FDP-në</b>	
Qarkullim i tatueshëm	1,021,211,275
Zbriten faturat e Dhjetorit të deklaruara në librat e muajit Janar	28,722,991
Shtohen diferencat e këmbimit të përfshira në të ardhura të tjera	(323,388)
<b>Shuma e qarkullimit e korrektuar</b>	<b>1,049,610,878</b>
Sipas Kontabilitetit	1,049,610,878
	-

15. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Fitime nga kursi këmbimit	6,594,787	1,736,322
Humbje nga kursi këmbimit	(6,918,175)	(2,395,112)
Të ardhurat të tjera	195,525	-
	<b>(127,863)</b>	<b>(658,790)</b>

16. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, lëndeve të para dhe shërbimeve të konsumuara që lidhen me veprimtarinë e shfrytëzimit. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Blerje energjie	950,555,322	372,721,817
Shpenzime për alokimin e kapaciteteve	47,667,089	49,500,657
Shpenzime për transmetimin	61,768	3,513,948
	<b>998,284,179</b>	<b>425,736,422</b>



**AYEN ENERGY TRADING sh.a**  
**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

*(Vlerat janë në Lek)*

**17. Të tjera shpenzime**

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>
Shpenzime poste dhe telekomunikacioni	1,292,454	1,534,977
Shpenzime qiraje	2,803,249	3,141,326
Shpenzime për shërbime bankare	1,922,231	1,004,401
Shpenzime ndërmjetesimi	1,712,378	4,182
Transferime, udhëtim dieta	1,085,809	671,795
Shpenzime të tjera ndaj personelit	827,838	428,682
Shpenzime energji, avull, ujë	195,893	424,260
Shpenzime noteriale dhe konsulence	734,570	123,076
Shpenzime kancelarie	103,824	391,585
Mirëmbajtje dhe riparime	1,507,740	336,601
Taksa të tjera	471,982	239,365
Shpenzime ushqimi	1,175,720	1,149,665
Shpenzime program moti	723,876	733,730
Shpenzime shëndeti	416,292	385,650
Shpenzime të tjera	754,874	683,870
	<u><b>15,728,730</b></u>	<u><b>11,253,165</b></u>

**18. Shpenzime të personelit**

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>
Shpenzime për paga	28,045,838	28,394,348
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	1,812,452	1,633,325
	<u><b>29,858,290</b></u>	<u><b>30,027,673</b></u>

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2016 është 10 (2015: 10).

**19. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit**

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjobat dhe penalitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>
Gjoba të ndryshme	128	107,190
	<u><b>128</b></u>	<u><b>107,190</b></u>



(Vlerat janë në Lek)

## 20. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit dhe rezultatin nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërisë. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Të ardhura nga kursi këmbimit nga aktiviteti financiar	1,333,706	1,845,160
Shpenzime interesi për huanë	(865,022)	(1,007,259)
Komision për letër garanci bankare	(2,973,902)	-
	<b>(2,505,218)</b>	<b>837,901</b>

## 21. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
<b>Fitimi para tatimit</b>	<b>1,757,474</b>	<b>(24,604,978)</b>
Shpenzime të panjohura të tjera (si mëposhtë)	<b>2,770,006</b>	<b>2,624,244</b>
Shpenzime të tjera personeli	1,148,836.00	1,257,021
Penalitet, gjoba e dëmshpërblime	128.00	107,190
Shpenzime për konsum personal	1,175,720.00	982,365
Shpenzime të tjera	445,322.00	277,668
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	<b>4,527,480</b>	<b>(21,980,734)</b>
Humbje fiskale e mbartur	(4,527,480)	-
<b>Tatim fitimi @15%</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
Tatim fitimi i vitit aktual	<b>-</b>	<b>-</b>

Shoqëria ka humbje tatimore të mbartura si paraqiten më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Humbje fiskale 2013 (skadojnë në 2016)	-	383,136
Humbje fiskale 2014 (skadojnë në 2017)	13,322,010	17,466,354
Humbje fiskale 2015 (skadojnë në 2018)	21,980,734	21,980,734
	<b>35,302,744</b>	<b>39,830,224</b>

Humbjet tatimore mund të mbarten deri në 3 vjet.

Nuk janë njohur aktive për tatime të shtyra në lidhje me këto zëra pasi nuk ka siguri se fitimi i ardhshëm i tatueshëm do të jetë i mjaftueshëm për të kompensuar humbjet tatimore të mbartura.



**AYEN ENERGY TRADING sh.a**  
**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

(Vlerat janë në Lek)

**22. Transaksionet me palët e lidhura**

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2016		31 dhjetor 2015	
	Të arkëtueshme	Të pagueshme	Të arkëtueshme	Të pagueshme
Ayen Enerji Doo Beograd	120,285,847		14,725,844	43,507,711
Ayen Electric Ticaret Anonim Sirketi		89,152,362	1,710,783	88,866,459
Ayen AS Energji sh.a		208,207,952		109,924,967
<b>Totali</b>	<b>120,285,847</b>	<b>297,360,315</b>	<b>16,436,627</b>	<b>242,299,137</b>

Detajet e transaksioneve me palët e lidhura gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2016		31 dhjetor 2015	
	Shitje	Blerje	Shitje	Blerje
Ayen Enerji Doo Beograd	300,869,491	348,666,796	113,599,103	59,046,693
Ayen Electric Ticaret Anonim Sirketi		761,893	1,717,645	
Ayen AS Energji sh.a	24,782,672	413,481,215	18,631,931	161,833,540
Interest expenses for Ayen Electric Ticaret Anonim Sirketi		865,022		1,007,259
<b>Totali</b>	<b>325,652,163</b>	<b>763,774,926</b>	<b>133,948,679</b>	<b>221,887,492</b>

Shpërblimin total të dhënë stafit drejtues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 është 1,184,154 LEK (2015: 1,184,154 LEK). Politika e vendosjes së çmimeve për transaksionet me palët e lidhura bëhet në bazë të kushteve të tregut.

**23. Manaxhimi i riskut financiar**

**Risku i kreditit**

Risku i kreditit është risku që pala tjetër të mos ketë mundësi të paguajë detyrimet e saj të lindura si pasojë e një instrumenti financiar apo një marrëveshje duke sjellë humbje financiare. Ekspozimi nga risku i kreditit vjen nga aktivitete operative. Shoqëria kontrollon riskun e kreditit që lidhet me klientët e saj duke monitoruar vazhdimisht shumatat e pambledhura.

Analiza e maturimitit të aktiveve financiare paraqitet më poshtë:

Përshkrimi	31 dhjetor 2016			
	Deri në 6 muaj	6 deri 12 muaj	1 deri 5 vjet	Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	262,332,777		938,468	263,271,245
Mjete monetare në arkë dhe bankë	60,478,222			60,478,222
<b>Totali</b>	<b>322,810,999</b>	<b>-</b>	<b>938,468</b>	<b>323,749,467</b>

Përshkrimi	31 dhjetor 2015			
	Deri në 6 muaj	6 deri 12 muaj	1 deri 5 vjet	Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	118,221,647	11,630,494	1,447,786	131,299,927
Mjete monetare në arkë dhe bankë	69,065,502	-	-	69,065,502
<b>Totali</b>	<b>187,287,149</b>	<b>11,630,494</b>	<b>1,447,786</b>	<b>200,365,429</b>



**AYEN ENERGY TRADING sh.a**  
**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

*(Vlerat janë në Lek)*

**23. Manaxhimi i riskut financiar (vazhdim)**

**Risku i likuiditetit**

Risku i likuiditetit është risku që kompania të hasë ndonjë vështirësi në përmbushjen e detyrimeve të lidhura me detyrimet financiare që likuidohen nëpërmjet parave apo aktiveve të tjera financiare.

Më poshtë paraqiten aktivet dhe pasivet financiare sipas maturitetit kontraktual të tyre më 31 dhjetor 2016 dhe më 31 dhjetor 2015.

**31 dhjetor 2016**

Përshkrimi	Deri në 6 muaj	6 deri 12 muaj	1 deri 5 vjet	Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	262,332,777	-	938,468	263,271,245
Mjete monetare në arkë dhe bankë	60,478,222	-	-	60,478,222
<b>Totali</b>	<b>322,810,999</b>	<b>-</b>	<b>938,468</b>	<b>323,749,467</b>
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(281,754,816)	-	-	(281,754,816)
Hua	-	(88,397,775)	-	(88,397,775)
<b>Totali</b>	<b>(281,754,816)</b>	<b>(88,397,775)</b>	<b>-</b>	<b>(370,152,591)</b>
<b>Risku i likuiditetit më 31 Dhjetor 2016</b>	<b>41,056,183</b>	<b>(88,397,775)</b>	<b>938,468</b>	<b>(46,403,124)</b>

**31 dhjetor 2015**

Përshkrimi	Deri në 6 muaj	6 deri 12 muaj	1 deri 5 vjet	Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	130,361,459	-	938,468	131,299,927
Mjete monetare në arkë dhe bankë	69,065,502	-	-	69,065,502
<b>Totali</b>	<b>199,426,961</b>	<b>-</b>	<b>938,468</b>	<b>200,365,429</b>
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(160,508,519)	-	-	(160,508,519)
Hua	-	(88,866,459)	-	(88,866,459)
<b>Totali</b>	<b>(160,508,519)</b>	<b>(88,866,459)</b>	<b>-</b>	<b>(249,374,978)</b>
<b>Risku i likuiditetit më 31 Dhjetor 2015</b>	<b>38,918,442</b>	<b>(88,866,459)</b>	<b>938,468</b>	<b>(49,009,549)</b>

**Risku i monedhës**

Ekspozimi i shoqërise ndaj riskut të monedhës së huaj më 31 dhjetor 2016 dhe më 31 dhjetor 2015 është si më poshtë:

Përshkrimi	31 Dhjetor 2016			Total
	EUR	GBP	LEK	
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	218,332,860	-	44,938,385	263,271,245
Mjete monetare në arkë dhe bankë	56,968,130	397	3,509,695	60,478,222
<b>Totali</b>	<b>275,300,990</b>	<b>397</b>	<b>48,448,080</b>	<b>323,749,467</b>
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(277,367,498)	-	(4,387,318)	(281,754,816)
Hua	(88,397,775)	-	-	(88,397,775)
<b>Totali</b>	<b>(365,765,273)</b>	<b>-</b>	<b>(4,387,318)</b>	<b>(370,152,591)</b>
<b>Risku i kursit të këmbimit më 31 Dhjetor 2016</b>	<b>(90,464,283)</b>	<b>397</b>	<b>44,060,762</b>	<b>(46,403,124)</b>



23. Manaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

Risku i monedhës (vazhdim)

Përshkrimi	31 Dhjetor 2015			
	EUR	GBP	LEK	Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	106,777,569	-	24,522,358	131,299,927
Mjete monetare në arkë dhe bankë	65,291,657	470	3,773,375	69,065,502
<b>Totali</b>	<b>172,069,226</b>	<b>470</b>	<b>28,295,733</b>	<b>200,365,429</b>
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(157,126,619)	-	(3,381,900)	(160,508,519)
Hua	(88,866,459)	-	-	(88,866,459)
<b>Totali</b>	<b>(245,993,078)</b>	<b>-</b>	<b>(3,381,900)</b>	<b>(249,374,978)</b>
<b>Risku i kursit të këmbimit më 31 Dhjetor 2015</b>	<b>(73,923,852)</b>	<b>470</b>	<b>24,913,833</b>	<b>(49,009,549)</b>

Risku i normes së interesit

Risku i normës së interesit përfaqëson riskun që vlera e instrumentave financiare do të luhetet nga ndryshimet në treg të normës së interesit dhe riskun që maturiteti i aktiveve financiare që mbartin interes të jetë i ndryshëm nga maturiteti i pasiveve financiare që mbartin interes.

Shoqëria ka një hua nga aksioneri i vetem Ayen Electric Ticaret Anonim Sirketi me norma interesi fikse.

24. Angazhime dhe pasiguri

Më 31 dhjetor 2016 kompania kishte kontrata qeraje operative në lidhje me marrjen me qera të zyrave në Tiranë. Minimumi i pagesave të ardhshme sipas kontratave janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Brenda një viti	2,758,692	2,800,512
Më shumë se një vit por më pak se pesë vite	2,528,801	5,367,648
	<b>5,287,493</b>	<b>8,168,160</b>

25. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

